

Bashkim Jashari pret delegacionin e Gardës Kombëtare të Ajevës, diskutohet avancimi i FSK-së | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PROTESTAT 'JO NË EMRIN TIM' MARRIN MBËSHTETJE TË MADHE NË KOSOVË E DIASPORË: INSTITUCIONET TË VEPROJNË SA MË SHPEJT.

 | FAQE 3

Në natën e tetë të protestës në Prishtinë, organizatori Çlirim Haziri u bëri thirrje institucioneve të Kosovës ta trajtojnë dhe votojnë


Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe të sigurojnë mbështetje financiare për mbrojtjen

e ish-krerëve të UÇK-së. Protesta të ngjashme në mbështetje të tyre po zhvillohen edhe në diasporë, në qytete ku jetojnë shqiptarët

VEÇ EDHE 12 DITË AFAT PËR PRESIDENTIN, A DO TË EVITOHEM ZGJEDHJET E KATËRTA BRENDË DY VJETËSH?

 | F. 4-5

AKTUALE



VLORA HYSANI PARA GJYKATËS, PËRPLASJE NË KUVEND PËR RASTIN E ISH-SHEFES SË SHISH-it | F. 5

RUBIO THOTË SE SERBIA ËSHTË E PËRFSHIRË NË "ÇËSHTJE POTENCIALISHT PROBLEMATIKE DHE SHPËRTHYESE" | F. 2

TRI VJET NGA RËNIA E AFRIM BUNJAKUT, KËRKOHET DREJTËSI PËR SULMIN NË BANJSKË | F. 7

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI PRITI EKSPERTËT E BANKËS BOTËRORE: QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE, PRIORITET I BQK-së | F. 8

KOMUNAT DHE INSTITUCIONET DISKUTOJNË RRUGËN PËR INVESTIME KOMUNALE NË ENERGJI TË RIPËRTERISHME | F. 8

SPORT



10 TOP-FUTBOLLISTËT QË MUND TË TRANSFEROHEN FALAS | F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUBIO THOTË SE SERBIA ËSHTË E PËRFSHIRË NË ‘ÇËSHTJE POTENCIALISHT PROBLEMATIKE DHE SHPËRTHYESE’

UASHINGTON, 24 SHTATOR - Serbia është e përfshirë në “çështje potencialisht problematike dhe shpërthyes”, ka thënë Marco Rubio, sekretari amerikan i Shtetit, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve para largimit nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork më 23 shtator. “Është e qartë se Serbia është e përfshirë në çështje të caktuara që janë potencialisht problematike dhe shpërthyes dhe që tërheqin vëmendjen ndërkombëtare”, theksoi Rubio, pa shpjeguar hollësisht se për cilat çështje bëhej fjalë.

Ai shtoi se sa iu përket marrëdhënieve të ShBA-së me Serbinë, Uashingtoni ka një partneritet strategjik me të, të cilin dëshiron ta thellojë. “Ne synojmë ta bëjmë këtë, ndërkohë që njëkohësisht adresojmë problemet e mundshme që mund të shfaqen, për të cilat e di se janë thellësisht të rëndësishme edhe për vetë ata”, tha Rubio.

Ai tha se Serbinë tashmë e kanë vizituar zyrtarë nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe agjenci të tjera qeveritare. “Shpresoj që edhe unë do të kem mundësinë ta vizitoj atë”, tha Rubio.

Në korrik, Shtetet e Bashkuara dhe Serbia nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për infrastrukturën energjetike dhe sigurinë energjetike rajonale në kuadër të procesit të dialogut strategjik të zhvilluar në Uashington.

Takimin mes zyrtarëve amerikanë dhe serbë asokohe e hapi vetë Rubio.

Në gusht, anëtarë republikanë dhe demokratë të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan paraqitën një projektligj që i kërkon ShBA-së të ndërmarrë masa ndaj Serbisë për shkak të “prapambetjes serioze” në demokraci dhe sundimin e ligjit në vend, si dhe bashkëpunimit me Rusinë, Kinën dhe Iranin.



Sipas projektligjit, Serbia ka shënuar prapambetje serioze në fushën e demokracisë, gjë që është pasqyruar në Raportin për të Drejtat e Njeriut për vitin 2024 dhe në Raportin e Parlamentit Evropian për Serbinë për vitin 2025, ku përmenden probleme të konsiderueshme me sundimin e ligjit, pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e medias dhe korrupsionin. Edhe pse është kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Serbia për gati pesë vjet nuk ka hapur asnjë kapitull të ri

negociatash, ndër të tjera, për shkak të përparimit të pamjaftueshëm në fushën e sundimit të ligjit, por edhe për shkak të mospërputhjes së politikës së saj të jashtme me atë të BE-së.

Dy muaj pas hapjes së kapitullit të fundit, Rusia e nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, ndërsa Serbia nuk e përshtati politikën e saj të jashtme me Bashkimin Evropian dhe nuk vendosi sanksione ndaj Rusisë. Kjo ishte atëherë arsyeja kryesore

për ngecjen e negociatave të anëtarësimit ndërsa, në ndërkohë, gjendja në fushën e sundimit të ligjit është përkeqësuar.

Së fundmi, edhe kongresisti amerikan Joe Wilson propozoi që takimi vjetor i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së të zhvendoset nga Serbia në Karolinën e Jugut, duke shpjeguar se arsyeja kryesore për këtë propozim ishte “ndikimi i tepruar” i presidentit rus, Vladimir Putin, në Serbi.

Beogradi zyrtar vitet e fundit ka mbajtur gjithashtu marrëdhënie miqësore me Iranin pavarësisht se ky shtet është nën sanksione ndërkombëtare për shkak të aktiviteteve të tij bërthamore dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ministri serb i Informimit dhe Telekomunikacionit, Boris Bratina, ishte ndër të paktët përfaqësues evropianë në funeralin e liderit suprem të Iranit, ajatollah Ali Khamenei, në muajin korrik.

IRANI DHE SHBA-JA MBETEN LARG MARRËVESHJES PAVARËSISHT PREJ RINISJES SË BISEDIMEVE

NJU-JORK, 24 SHTATOR - Irani dhe Shtetet e Bashkuara janë ende shumë larg arritjes së ndonjë marrëveshjeje për t'i dhënë fund luftës së tyre gati shtatëmuajshe pavarësisht prej rinisjes së bisedimeve diplomatike, tha më 23 shtator një zyrtar iranian.

Ndërkohë, presidenti iranian, Masoud Pezeshkian, e kundërshtoi trysninë amerikane në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Zyrtari iranian i tha “Reuters”-it se Teherani po shqyrtonte përgjigjen e Uashingtonit ndaj propozimeve iraniane, të përqendruara në heqjen e bllokadës detare amerikane dhe rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, por tha se “ka ende shumë dallime” mes palëve.

Shtetet e Bashkuara dhe Irani

zhvilluan bisedime indirekte të mërkurën për herë të parë pas disa muajve. Asnjëra palë nuk dha deklaratë publike pas bisedimeve.

Pezeshkian tha në OKB se Irani nuk do të “përkulej në gjunjë” si pasojë e trysnisë, një ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump, në fjalimin e tij në OKB, kërcënoi se do ta “asgjësonte” Iranin nëse nuk do të arrihej një marrëveshje.

Megjithatë, Pezeshkian tha se Teherani mbetet i hapur për bisedime.

Dy liderët u përplasën edhe për programin bërthamor të Iranit. Pezeshkian tha se Teherani nuk synon armë bërthamore, por nuk do të heqë dorë nga teknologjia bërthamore për qëllime paqësore, ndërsa



Trumpi e akuzoi Iranin se po synon të prodhojë bombë atomike dhe u zotua: “Nuk do ta lejoj kurrë Iranin të ketë armë bërthamore”. Ai i mbrojti gjithashtu kufizimet e Iranit në Ngushticën e Hormuzit, përmes

së cilës para luftës kalonte rreth një e pesta e naftës globale dhe e gazit natyror të lëngshëm. Tani Hormuzi është bërë pika qendrore e mosmarrëveshjeve në bisedimet mes Iranit dhe Uashingtonit.

Po më 23 shtator presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, tha se kishte biseduar me Pezeshkianin dhe i kishte bërë thirrje Iranit ta ofronte lirinë e lundrimit, t'i ndalte sulmet ndaj vendeve fqinje dhe ta rifillonte bashkëpunimin me mbikëqyrësin bërthamor të OKB-së.

Trumpi shpesh ka kërcënuar me sulme të mëdha ndaj Iranit, më pas i ka anuluar ato, duke pretenduar se një marrëveshje mes Uashingtonit dhe Teheranit ishte afër që të arrihej.

Deri tani nuk është arritur ndonjë marrëveshje e qëndrueshme e paqes, teksa sulmet reciproke kanë rinisur.

Në qershor u arrit një memorandum mirëkuptimi që synonte t'u jepte të dyja palëve 60 ditë për të negociuar një marrëveshje të gjerë paqeje dhe për t'i dhënë fund luftës që nisi në fund të shkurtit me sulmet ajrore të ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit.

Ky i fundit u kundërpërgjigj me sulme në rajon.

Por, memorandum i qershorit dështoi shpejt, pasi luftimet rifilluan kryesisht rreth Ngushticës së Hormuzit, një rrugë jetike globale për transportin e dërgesave të energjisë dhe produkteve të konsumit.

CIA PARALAJMËRON PËR SULME TË MUNDSHME RUSE ME DRONË NDAJ ITALISË, FRANCËS DHE SPANJËS

UASHINGTON, 24 GUSHT - Shtetet e Bashkuara kanë paralajmëruar disa vende evropiane për një skenar të mundshëm të përshkallëzimit rus, që përfshin sulme me dronë ndaj objektivave në Itali, Francë ose Spanjë.

Informacioni është publikuar nga gazeta spanjolle “El Mundo”, e cila raporton se intelijenca amerikane ka mbledhur të dhëna mbi planet e mundshme të Moskës dhe i ka ndarë ato me qeveri evropiane.

Sipas raportimeve, dronët mund

të lëshohen nga anije tregtare në Detin Mesdhe, të fshehur në kontejnerë. Burime pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Lituaniës i kanë thënë “El Mundo”-s se modeli që mund të përdoret është dronë Gerbera, me një rreze veprimi të raportuar deri në 600 kilometra.

Raportimi e lidh paralajmërimin me vizitën e drejtorit të CIA-s, John Ratcliffe, në Moskë, më 25 gusht, pas së cilës informacionet mbi një skenar të mundshëm sulmi u shpërndanë te disa vende evropiane. Megjithatë,

nga Italia ka ardhur një kundërvërejtje e rëndësishme: burime të cituara nga ANSA deklaruan se deri tani nuk ka mbërritur ndonjë alarm në nivel operacional, ndërsa ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto, ka thënë se pretendimi nuk ka gjetur konfirmim.

Raportimi vjen në një kohë kur vendet evropiane kanë rritur vëmendjen ndaj kërcënimeve hibride dhe incidenteve me dronë, përfshirë raste të raportuara së fundmi në hapësirën evropiane.



PROTESTAT ‘JO NË EMRIN TIM’ MARRIN MBËSHTETJE TË MADHE NË KOSOVË E DIASPORË: INSTITUCIONET TË VEPROJNË SA MË SHPEJT

Në natën e tetë të protestës në Prishtinë, organizatori Çlirim Haziri u bëri thirrje institucioneve të Kosovës ta trajtojnë dhe votojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe të sigurojnë mbështetje financiare për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së. Protesta të ngjashme në mbështetje të tyre po zhvillohen edhe në diasporë, në qytete ku jetojnë shqiptarët

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Organizatori i protestës “Jo në emrin tim”, Çlirim Haziri, u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës të veprojnë sa më shpejt ndaj kërkesave të protestuesve. Në natën e tetë të tubimit në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, ai kërkoi trajtimin dhe votimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara si dhe mbështetje me fonde për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së. “Mosveprimi i institucioneve nuk mund të zgjasë pafund. Sepse ne nuk e durojmë padrejtësinë. Populli nuk e duron heshtjen. Pritjes sonë po i vjen fundi. Durimi ynë po përfundon. Nga ky shesh u themi institucioneve: Veproni sa më shpejt! Mos e ngatërmoni qetësinë tonë të deritanishme me dobësi!”, deklaroi Haziri.

Ai tha se protestuesit nuk do të heshtin përballë mosveprimit institucional dhe se do të vazhdojnë të mblidhen derisa kërkesat e tyre të marrin përgjigje. “Dikush ka menduar se do të dilnim një natë. Dikush ka menduar se pas dy-tri netësh do të lodheshim. Dikush ka pritur që ky shesh të zbrazej. Por le ta shohin këtë shesh sonte! Jemi ende këtu!”, tha organizatori i protestës.

Haziri i falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre përgjatë tetë

netëve. Sipas tij, dalja e qytetarëve në shesh është shprehje e mbështetjes për UÇK-në dhe e kundërshtimit ndaj asaj që protestuesit e konsiderojnë padrejtësi nga Gjykata Speciale. “Çdo natë populli erdhi në shesh, sepse UÇK-ja është e popullit dhe populli është i UÇK-së”, u shpreh ai, duke shtuar se qytetarët janë bërë bashkë “kundër harresës dhe kundër shtrembërimit të së vërtetës”.

Në një pjesë të fjalimit, Haziri u ndal te familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Ai u kërkoi të pranishmëve të mendonin për çastin kur, pas përfundimit të protestës, do të kthehen në shtëpitë dhe te familjet e tyre, ndërsa katër ish-krerët e UÇK-së do të kalojnë edhe një natë larg të afërmeve. “Dikush do t’i përqafojë fëmijët. Dikush do ta gjejë nënën duke e pritur. Dikush do të ulet me gruan, me burrin, me familjen e tij. Dhe nesër në mëngjes do të zgjohemi të lirë. Por Hashimi sonte nuk kthehet në shtëpi. Kadriu sonte nuk kthehet në shtëpi. Rexha sonte nuk kthehet në shtëpi. Jakupi sonte nuk kthehet në shtëpi”, tha ai. Sipas Hazirit, mundësia e qytetarëve për t’u kthyer të lirë në shtëpi sjell edhe përgjegjësinë për ta ngritur zërin për ata që mbahen në Hagë. “Liria nuk është vetëm e drejtë. Liria është edhe përgjegjësi. Përgjegjësi për të mos harruar, për të mos heshtur, për të mos i lënë vetëm”, deklaroi ai.

Nga sheshi, Haziri iu drejtua me emër Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit, duke u përcjellë mesazhin se familjet e tyre kanë mbështetjen e protestuesve. “Ndoshta sonte nuk na dëgjoni. Por dijeni: Kosova nuk ju ka harruar! Populli juaj është këtu! Fëmijët tuaj nuk janë vetëm! Familjet tuaja nuk janë vetëm!”, u shpreh ai.

Organizatori i protestës foli edhe për mungesën që, sipas tij, lë te fëmijët dhe tek të afërmit qëndrimi i një prindi larg shtëpisë. “Kur një baba është pas grilave, mungesa e tij nuk mbetet pas atyre grilave. Ajo hyn në shtëpi. Ulet në tavolinën e familjes. Ndihet në çdo festë. Në çdo ditëlindje. Në çdo përqaftim që mungon”, tha Haziri.

Familja Thaçi, Veseli dhe Krasniqi: Presim përgjegjësi shtetërore dhe unitet qytetar

Familja e Hashim Thaçit, e Kadri Veselit dhe e Jakup Krasniqit kanë publikuar një letër të përbashkët,

përmes së cilës kanë bërë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe unitet qytetar lidhur me zhvillimet pas procesit gjyqësor në Hagë. Në një letër të publikuar nga Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, familjet kanë shprehur mirënjohje për qytetarët e Kosovës për mbështetjen dhe solidaritetin e vazhdueshëm ndaj procesit gjyqësor në Hagë. “Letër e familjeve Thaçi, Veseli dhe Krasniqi. Ne, familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit, bëjmë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe unitet qytetar në këto momente. Shprehim mirënjohjen tonë të thellë për popullin e Kosovës për mbështetjen, solidaritetin dhe qëndrimin e tij të vazhdueshëm ndaj procesit gjyqësor në Hagë. Presim sjellje të përgjegjshme shtetërore nga të zgjedhurit e popullit, në mbrojtje të Kushtetutës dhe ligjit, në raport me Dhomat e Specializuara. E vlerësojmë ftesën e Albulena Haxhiut, por, për t’iu shmangur çdo keqkuptimi të mundshëm lidhur me ndikimin dhe ndërhyrjet familjare në vendimmarrjen e institucioneve të Republikës së Kosovës, presim që të takohemi pas vendimit të Kuvendit”, thuhet në këtë letër.

PDK-ja mbështet protestat e OVLUÇK-së, platformat qytetare dhe protestat e shqiptarëve në Kosovë e diasporë

Partia Demokratike e Kosovës ka bërë me dije se mbështet protestat e nesërme në të gjitha komunat e Kosovës, të thirrura nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat do të mbahen në qytete të ndryshme të vendit, pas vendimit të padrejtë të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. PDK e konsideron të domosdoshëm respektimin e zërit të qytetarëve, të cilët përmes

këtyre protestave po shprehin kundërshtimin e tyre ndaj këtij vendimi.

Njëkohësisht, Partia Demokratike e Kosovës vlerëson lart të gjitha protestat që tash e dhjetë ditë po zhvillohen në Kosovë, si dhe protestat e shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Australi, në vende të ndryshme të Evropës dhe kudo tjetër në botë, ku qytetarët po shprehin mospajtimin e tyre ndaj këtij vendimi.

“Pjesëmarrja e qytetarëve në sheshet e Kosovës, për dhjetë ditë me radhë, përcjell një mesazh të qartë nga protestuesit se vendimi i Gjykatës Speciale nuk është marrë në emër të popullit të Kosovës. Krahas këtyre protestave të organizuara deri tani, PDK i fton qytetarët që të marrin pjesë masivisht edhe në protestën e thirrur nga platforma ‘Liria ka emër’, më 1 tetor, në sheshin ‘Skënderbeu’ në Prishtinë. Reagimi qytetar në Kosovë dhe në diasporë është një zhvillim publik që institucionet e vendit duhet ta trajtojnë me seriozitet. Kundërshtimi ndaj vendimit të Hagës po shprehet çdo ditë në sheshe, në mënyrë paqësore dhe demokratike”, thuhet në komunikatën e PDK-së.

Në të njëjtën kohë, thuhet se përgjegjësia institucionale nuk përfundon te qytetarët që protestojnë. “Institucionet e Kosovës dhe spektri politik duhet t’i trajtojnë me seriozitet dhe urgjencë hapat institucionalë dhe ligjorë që lidhen me procesin e padrejtë ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe fazat e mëtejshme të tij. Partia Demokratike e Kosovës do të vazhdojë angazhimin e saj politik dhe institucional lidhur me procesin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, duke e konsideruar prioritet votimin në Kuvendin e Kosovës të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara”, është theksuar në komunikatën e PDK-së.





VEÇ EDHE 12 DITË AFAT PËR PRESIDENTIN, A DO TË EVITOHEN ZGJEDHJET E KATËRTA BRENDA DY VJETËSH?

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, është zgjedhur në përputhje me Kushtetutën, ndërsa ka sqaruar se afati për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit është deri më 6 tetor. Sa i përket zgjedhjes së presidentit, gjykata ka theksuar se afati 60 ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht dhe përfundon më 6 tetor. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se urgjenca kryesore është çështja e presidentit, duke theksuar se mbetet e diskutueshme se kush do të marrë vendim më 7 tetor për caktimin e 8 ose 15 nëntorit si datë e zgjedhjeve të reja

PRISHTINE, 24 SHTATOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës tha se Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, u zgjodh në përputhje me Kushtetutën, teksa sqaroi se afati për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit është deri më 6 tetor. Sa i përket zgjedhjes së presidentit, gjykata tha, po ashtu, se afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht dhe përfundon më 6 tetor. Njoftimi nga gjykata më e lartë në vend vjen pasi Partia Demokratike e Kosovës kontestoi edhe konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. Kushtetuesja, po ashtu, rrëzoi kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme për punimet e Kuvendit. Sa i përket Kuvendit - që u konstituua më 13 shtator dhe disa orë më vonë u zgjodh edhe qeveria - Kushtetuesja tha se deputetët duhet ta zgjedhin edhe nënkryetarin e dytë, duke

konstatuar se organi ligjvënës u konstituua përtej afatit 30-ditor. Më 13 shtator, pa praninë e deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Aleancës, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ata të komuniteteve joshumicë, votuan për konstituimin e Kuvendit. Më vonë gjatë ditës u votua edhe qeveria e re e udhëhequr nga Albin Kurti. Kabineti qeverisës është po i njëjti me atë të kaluarin dhe të pranishëm në seancë për zgjedhjen e qeverisë nuk ishin PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca.

Reagimet e partive pas vendimit

Përparim Gruda, deputet i PDK-së, tha se vendimi i gjykatës konfirmon parimin se afatet kushtetuese nuk janë çështje vullneti politik dhe Kushtetuta

nuk mund të përshtatet sipas interesave të momentit". Sipas tij, gjykata gjeti se u shkel afati 30 ditor për Kuvendin dhe se nënkryetari i PDK-së duhet të zgjidhet dhe nuk mund të "anashkalohet apo të mbetet peng i vullnetit të shumicës parlamentare". "Tani kemi vetëm 13 ditë kohë për të vepruar: për t'i miratuar ndryshimet në Ligjin për Gjykatën Speciale, për ta zgjedhur presidentin e Republikës dhe për t'i shmangur zgjedhjet e reja. Koha është e kufizuar dhe përgjegjësia tashmë është e qartë", shkroi ai në "Facebook". Ndërkaq, Aleanca tha se gjykata konstatoi atë që ky subjekt ka argumentuar se janë konsumuar afatet për konstituimin e Kuvendit. Megjithatë, kjo parti tha se vendi po shkon drejt zgjedhjeve dhe për këtë fajësoi Albin Kurtin. "Gjykata Kushtetuese e nxori Kosovën prej një momenti të paparashikuar krize, 6 tetorin, të cilën datë, po

ashtu, partia që i fitoi zgjedhjet e kaluara e priste", thuhet në reagimin e Aleancës.

Cakolli pas vendimit të Kushtetueses: Urgjenca kryesore, zgjedhja e presidentit

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë për "Radion Evropa e Lirë" se njoftimi për aktgjykimin duhet të shihet në dy aspekte: në njërin anë, sipas tij, legjitimon në aspektin kushtetues zgjedhjen e institucioneve pas afatit kushtetues, në anën tjetër periudhën brenda së cilës duhet të formohen institucionet në Kosovë. Ai vlerëson se urgjenca kryesore është çështja e presidentit. "Gjykata ka përcaktuar praktikisht një afat 90-ditor brenda të cilit duhet të zgjidhen të gjitha institucionet përkatëse pas zgjedhjeve, në varësi se a kemi shkuar në zgjedhje për presidentin apo jo", thotë Cakolli. Megjithatë, sipas Cakollit, çështja më "problematike dhe më diskutabile" në këtë vendim është fakti që, sipas tij, caktimi i 6 tetorit si datë e fundit për zgjedhjen e presidentit "e bën të paqartë situatën se kush do t'i shpallë eventualisht zgjedhjet më 7 tetor, pra dy javë nga sot, nëse Kuvendi nuk arrin ta zgjedhë presidentin". Ai argumenton se në Kushtetutë ushtruesi i detyrës së presidentit,

në këtë rast Albulena Haxhiu, mund ta ushtrojë këtë post vetëm gjashtë muaj, ndonëse thotë se kjo çështje mund të dërgohet në të ardhmen në Kushtetuese për sqarim. "Pra, mbetet diskutabile se kush do të marrë vendim më 7 tetor për ta caktuar 8 ose 15 nëntorin si datë të zgjedhjeve, meqë këto janë dy opsionet e vetme ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, në rast se Kuvendi dështon ta zgjedhë presidentin e ri", thotë Cakolli. Sipas tij, Kuvendi do të duhej t'i vazhdonte punimet menjëherë pas publikimit të aktgjykimit, por ai vlerëson se çështja kyçe është ajo e presidentit. "Urgjenca kryesore mbetet zgjedhja e presidentit sepse jemi vetëm dy javë larg nga skadimi i afatit dhe me gjithë dinamikat politike që kemi, vlerësoj se ekziston një rrezik i pamundësisë për të gjetur sërish marrëveshje që do ta çonte Kosovën drejt ciklit të ri zgjedhor, përkatësisht të katërtit në më pak se dy vjet", vlerëson ai. Cakolli sqaron se 6 tetori është caktuar duke llogaritur ditën e parë pas skadimit të afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit dhe ditën e fundit të 60-ditëshit brenda së cilës supozohet se duhet të kryhet edhe zgjedhja e presidentit. Sa i përket çështjes së konstituimit të Kuvendit, Cakolli tha se për shkak se gjykata ka përcaktuar se edhe pse afati 30-ditor për konstituimin e Kuvendit është obligues, "deputetët do të

VLORA HYSENI PARA GJYKATËS, PËRPLASJE NË KUVEND PËR RASTIN E ISH-SHEFES SË SHISH-IT

TIRANË, 24 SHTATOR - Ish-drejtoresha e Shërbimit Informativ të Shtetit (ShISH) në Shqipëri, Vlora Hyseni, ka hyrë në gjykatë si e dyshuar për veprat penale “zbulimi i të dhënave sekrete” dhe “përkrahja e autorit të krimit”.

Hyseni u shkarkua të martën nga detyra e drejtueses së shërbimit sekret të vendit, pasi gjykata urdhëroi vendosjen e saj në arrest shtëpiak, nën dyshimin se ka nxjerrë të dhëna të klasifikuara në kuadër të një hetimi më të gjerë për korrupsion.

Hollësi mbi të dhënat që dyshohet se janë zbuluar nuk janë bërë publike.

Por, sipas burimeve, të dhëna sekrete dyshohet se i janë dorëzuar Ergys Agasit, një prej biznesmenëve të përfshirë në hetimin lidhur me një rast korrupsioni në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ku po hetohen dyshime për veprimtari kriminale dhe manipulim të procedurave të prokurimit publik.

Një numër zyrtarësh shtetërorë dhe biznesmenësh janë arrestuar ose po hetohen për keqpërdorim të parave publike në AKSHI.

Hetimi ndaj Hysenit ka ngritur pikëpyetje edhe për sigurinë institucionale dhe kombëtare të Shqipërisë.

Para gjykatës kanë dalë edhe dy persona të tjerë që po hetohen në kuadër të këtij hetimi, njëri punonjës i policisë gjyqësore, tjetri biznesmen. Ata janë dërguar në paraburgim.

Përplasje në Kuvend për rastin Hyseni

Ndërkohë, rasti i Hysenit ka shkaktuar përplasje edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Shumica parlamentare rrëzoi kërkesën e Partisë Demokratike për ndryshimin e rendit të ditës dhe

zhvillimin e debatit për rastin e ish-drejtorese të ShISH-it. Pas këtij vendimi, deputetët e opozitës rrethuan foltoren, ndërsa seanca u ndërpre për disa minuta.

Seanca u ndërpre pas fjalës së kreut të Partisë Demokratike, Sali Berisha, i cili tha se Kuvendi nuk mund të diskutonte asnjë çështje tjetër pa trajtuar rastin e Hysenit. Berisha kërkoi dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama, duke e cilësuar situatën e krijuar pas hetimit ndaj ish-drejtoreshës së ShISH-it si një çështje me pasoja të rënda për sigurinë kombëtare. “Ky është parlamenti i Ergys Agasit”, deklaroi Berisha.

Ai pretendoi se emërimi i Hysenit në krye të ShISH-it ka dëmтуar rëndë sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me shërbimet partnere. “Ka rënë siguria kombëtare”, tha Berisha, duke kërkuar hetim të plotë të çështjes.

Berisha pretendoi se Hyseni e kishte pajisur “organizatën kriminale të Ergys Agasit” me mjete të sofistikua që, sipas tij, ishin blerë me paratë e taksapaguesve shqiptarë ose ishin dhuruar nga partnerët për nevojat e sigurisë kombëtare. “Siç rezultoi [Vlora Hyseni] e ka pajisur organizatën kriminale të Ergys Agasit me mjetet më të sofistikua. Aty në zyrë që krijoi [Agasi], të pajisur me të gjitha mjetet më të sofistikua, të blera nga taksapaguesit shqiptarë ose dhuratë e partnerëve tanë për sigurinë kombëtare, për vëzhgimin e armiqve, janë përdorur për të gjitha qëllimet e ulëta të luftës brenda klaneve”, tha Berisha në Kuvend.

Pretendimet e tij nuk janë konfirmuar në informacionet e bëra publike deri tani për hetimin.

Para votimit, grupi parlamentar i PD-së kishte kërkuar që Kuvendi t’i kërkonte kryeministrit Rama informacione dhe shpjegime për emërimin e Hysenit në krye të



ShISH-it dhe për veprimtarinë e saj gjatë drejtimit të institucionit. “Kuvendi i Shqipërisë duhet të kërkojë urgjentisht nga kryeministri Edi Rama që të japë informacione dhe shpjegime mbi përzgjedhjen e shtetases Vlora Hyseni në këtë detyrë, duke pasur parasysh rekordet e saj problematike në Republikën e Kosovës, si dhe veprimtarinë e saj në drejtimin e Shërbimit Informativ Shtetëror, të debatit mbi përgjegjësitë institucionale, si dhe të vlerësojë marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar fenomene të tilla në të ardhmen”, thuhet në kërkesën e grupit të PD-së.

Demokratët kishin kërkuar që nga rendi i ditës të hiqeshin interpelancat e parashikuara me ministrin e Mjedisit dhe atë të Arsimit dhe të shtohet një pikë e re: “Kontroll dhe debat parlamentar me Kryeministrin Edi Rama lidhur me situatën në ShISH”.

Jashtë Kuvendit, dhjetëra qytetarë po protestojnë, ndërsa policia ka rrethuar perimetrimin përreth ndërtesës për të mos lejuar afrimin e protestuesve. Protesta është pjesë e tubimeve të përditshme kundër qeverisë, por zhvillimet në ShISH dhe masa e sigurisë ndaj Hysenit janë kthyer në një nga temat kryesore të protestuesve.

Para nisjes së seancës, ministri i Drejtësisë, Toni Gogu, u pyet nga gazetarët për përgjegjësinë politike të qeverisë dhe shumicës lidhur me rastin Hyseni. Gogu tha se përgjegjësia penale është individuale dhe se qeveria e ka marrë përgjegjësinë politike duke e shkarkuar Hysenin nga drejtimi i ShISH-it dhe duke siguruar vazhdimësinë e institucionit me një drejtues të ri. Vlora Hyseni, e cila është me prejardhje nga Kosova, kishte drejtuar ShISH-in që nga viti 2023.

Më parë ajo kishte shërbyer si

zëvendësdrejtore të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Hyseni u shkarkua nga ky post në vitin 2021 nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti.

Qeveria e Kosovës nuk dha hollësi për arsyet e shkarkimit. Në komunikatën e atëhershme thuhej se vendimi ishte mbështetur në Ligjin për AKI-në. Në të njëjtën komunikatë përmendej se “zbulimi ose mosruajtja e informacioneve të klasifikuara” përbënte vepër penale sipas legjisllacionit në fuqi.

Pas largimit nga AKI-ja, Hyseni u bë këshilltare për sigurinë kombëtare e kryeministrit Edi Rama në shtator të vitit 2021.

Në vitin 2023 ajo u emërua drejtuese e ShISH-it në Shqipëri. Para dekretimit të saj, opozita shqiptare i kishte kërkuar presidentit Bajram Begaj të merrte informacione për arsyet e shkarkimit të Hysenit nga AKI-ja.

duhej ta respektonin dhe nëse nuk do të bëjnë një gjë të tillë, kjo nuk nënkupton që nuk rrjedhin afatet e tjera kushtetuese sepse ajo do të rrezikonte ta fuste vendin në kriza të pafundme kushtetuese”.

Ndërkaq, njohësi i çështjeve politike, Ilir Deda, shkroi menjëherë pas publikimit të vendimit të Kushtetueses se gjykata “e ktheu në binarë ligjshmërie” konstituimin e institucioneve pas zgjedhjeve. “Gjithashtu, e prishi matematikën e zgjedhjeve për 27 dhjetor. Tash që gjithçka është e qartë, po presim të shohim a ka çfarëdo mundësie për çfarëdo përbashkimi në këtë situatë - më të vështirën në këto 15 vjetët e fundit”, shkroi ai në “Facebook”. Partitë opozitare kishin fajësuar LV-në e Albin Kurtit se po zvarriste konstituimin e institucioneve në mënyrë që votimet e reja të mbaheshin në fund të vitit.

Çështja e presidentit

Çështja e presidentit ka qenë temë kyçe tash e një kohë në Kosovë, pasi për shkak të moskonsensusit për zgjedhjen e një kreu të ri të shtetit, u mbajtën edhe votimet e qershorit. Që nga 4 prilli Kosova është me ushtrues detyre të presidentit. Ky funksion, sipas Kushtetutës, nuk mund të ushtrohet më shumë se gjashtë muaj. Pas disa raundesh të bisedimeve mes LV-së të Albin Kurtit dhe LDK-së së Lumir Abdixhikut, palët arritën një marrëveshje në fund të gushtit për një president konsensual, dhe dy partitë propozuan për postin e presidentit Bekim Sejdiun. Por, një ditë pas njoftimit për marrëveshjen u bë me dije se gjashtë deputetë të LDK-së nuk e përkrahnin këtë kandidaturë - duke bërë që, në praktikë, Sejdiu të mos kishte 81 votat e

nevojshme - dy të tretat e Kuvendit me 120 ulëse, që kërkohen për procesin e zgjedhjes së presidentit. Pavarësisht prej kundërshtimit të gjashtë deputetëve të LDK-së, Kurti insistoi se marrëveshja ende qëndronte. Megjithatë, më 14 shtator Sejdiu njoftoi se tërhiqet nga kandidatura për president për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme për zgjedhjen e tij.

Kosova rrezikon të shkojë drejt zgjedhjeve të reja - që do të ishin të katërtat që nga shkurti i vitit 2025 - nëse partitë nuk gjejnë ujdi që ta zgjedhin kreun e ri të shtetit deri më 6 tetor, afatin e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese.

Si u konstituua Kuvendi?

Në një aktgjykim të mëparshëm, Kushtetuesja kishte thënë se

Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30-ditësh nga certifikimi i rezultatit zgjedhor. Ky afat përfundoi më 7 gusht. Lëvizja Vetëvendosje, fituesja e zgjedhjeve të qershorit, kishte argumentuar se afati 30-ditor kishte nisur më 6 gusht, kur nisi edhe seanca konstituive. Megjithatë, edhe ky afat u tejkalua, mes argumentimit nga LV-ja se kërkohej një marrëveshje për çështjen e presidentit para se të lëvizej përpara me konstituimin e Kuvendit. Seanca nisi më 6 gusht, por u ndërpre shpejt, pasi kreu i LV-së, Albin Kurti, kërkoi kohë shtesë për bisedime për çështjen e presidentit. Kërkesë të ngjashme ai bëri edhe në vazhdimin tjetër të seancës që u mbajt pas 48-orësh.

Kuvendi nuk e vazhdoi këtë seancë deri më 9 shtator, kur deputetët u mblodhën dhe rizgjedhën në krye të organit

ligjvënës Albulena Haxhiun. Por, në atë seancë, për shkak të mospajtimeve, të pesë nënkryetarët nuk u zgjedhën. Në vazhdimin e seancës së 11 shtatorit u zgjodh nënkryetari nga radhët e LV-së, Ardian Gola, por jo edhe Vlora Çitaku e PDK-së, fuqisë së dytë politike në vend. LV-ja tha se nuk mund të jepte vota për Çitakun dhe Kujtim Shalën e LDK-së që, sipas saj, synojnë ta çojnë vendin në zgjedhje. Më vonë, LV-ja ndryshoi mendim dhe më 13 shtator votoi për Shalën në postin e nënkryetarit. Por, PDK-ja tha se kishte tërhequr përkohësisht kandidaturën për nënkryetar duke paralajmëruar dërgim të lëndës në Kushtetuese, gjë që ndodhi më pas. Gjatë seancës së 13 shtatorit u zgjedhën edhe dy nënkryetarët nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Bashkim Jashari pret delegacionin e Gardës Kombëtare të Ajovës, diskutohet avancimi i FSK-së

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, priti në takim delegacionin e Gardës Kombëtare të Ajovës, të kryesuar nga shefi i shtabit të gardës ajrore të Ajovës, gjeneralbrigade Justin T. Wagner.

Gjatë takimit u diskutua për zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe për bashkëpunimin e ngushtë

ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës. Palët vlerësuan rëndësinë e partneritetit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët, duke shprehur përkushtimin për thellimin e mëtejshëm të këtij partneriteti. Ky bashkëpunim përbën një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin profesional dhe institucional të FSK-së si dhe në forcimin e marrëdhënieve të

partneritetit ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vlen të theksohet se gjatë kësaj jave në Forcën e Sigurisë së Kosovës po qëndron një delegacion i gjerë ekspertësh nga njësi të ndryshme të Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët janë angazhuar në fusha dhe aktivitete të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.



OIK ZHVILLON PUNËTORI PËR FORCIMIN E MBIKËQYRJES PROFESIONALE NË SHËNDETËSI

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK), me mbështetjen e IHS Project, organizoi punëtorinë me temë “Mbikëqyrja profesionale dhe zbatimi i Rregullores së OIK-ut”. Në aktivitet morën pjesë kryetarja e OIK-ut, Nexhmije Gori, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, kryeinspektori shëndetësor Labinot Zeqiri, kryetari i Gjykatës Administrative Kreshnik Kaçi, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, Shaban Osmanaj, përfaqësuesja e IHS-së, Fikrije Hasani, si dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë.

Në mënyrë online u kyçën edhe ekspertë nga Kroacia, të cilët ndanë përvojat e tyre profesionale në fushën e mbikëqyrjes



profesionistëve shëndetësorë. U theksua nevoja për përcaktim të kujdesshëm të kompetencave në përputhje me përgjegjësitë profesionale dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Pjesëmarrësit vlerësuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet OIK-ut, institucioneve shëndetësore, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Inspektoratit Shëndetësor për forcimin e mbikëqyrjes profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Në përfundim u shpreh pritja që diskutimet e punëtorisë dhe shkëmbimi i përvojave me ekspertët ndërkombëtarë të rezultojnë në një produkt konkret për avancimin e mbikëqyrjes profesionale dhe zbatimin e Rregullores së OIK-ut.

profesionale. Diskutimet u përqendruan në rolin e mbikëqyrësit profesional, zbatimin e Rregullores së OIK-ut dhe qartësimin e roleve, përgjegjësi dhe kompetencave të

ZULFAJ KËRKON MBËSHTETJEN E BUNDESTAGUT PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË KOSOVËS NË BE

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Në Bundestagun gjerman, kryenegociatori i Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian, Jeton Zulfaj, zhvilloi takim me Anton Hofreiter, kryetar i Komisionit për Çështjet e Bashkimit Evropian dhe deputetin e Aleancës 90/Të Gjelbrit, zëvendëskryetarin e Komisionit dhe deputetin e SPD-së, Johannes Schrap, dhe Peter Beyer, anëtar i Komisionit dhe deputetin e CDU/CSU-së.

Sipas një njoftimi për medie, Zulfaj u shoqërua nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti. “Kryenegociatori Zulfaj i falënderoi deputetët për mbështetjen e vazhdueshme të

Gjermanisë ndaj Kosovës, duke theksuar mirënjohjen e popullit të Kosovës për solidaritetin dhe përkrahjen gjermane në momentet vendimtare të historisë sonë - nga çlirimi dhe rindërtimi pas luftës, te rruga drejt pavarësisë, shtetndërtimi dhe zhvillimi ekonomik i vendit. Në fokus të takimit ishte avancimi i Kosovës në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian. Zulfaj theksoi se, pothuajse katër vjet pas dorëzimit të aplikimit për anëtarësim në BE, Kosova mbetet vendi i vetëm në rajon pa statusin e vendit kandidat. Ai kërkoi mbështetjen e Bundestagut që Këshilli i BE-së t’i kërkojë Komisionit Evropian përgatitjen e Opinionit për aplikimin e Kosovës

këtë vjeshtë”, thuhet në njoftim. Siç bëhet me dije në njoftimin për medie, kryenegociatori nënvizoi se Gjermania ka qenë dhe mbetet një nga partnerët më të rëndësishëm të Kosovës dhe se zëri i saj ka peshë të veçantë në politikën e zgjerimit të BE-së. “Në këtë drejtim, ai kërkoi angazhim proaktiv të parlamentarëve gjermanë, përfshirë përmes kontakteve me homologët e tyre në shtetet e tjera anëtare dhe familjet politike evropiane, për të ndihmuar në avancimin e aplikimit të Kosovës. Gjatë takimit u diskutua gjithashtu për progresin demokratik dhe ekonomik të Kosovës, zbatimin e reformave në kuadër të procesit të integritetit në BE, si dhe



përkushtimin e plotë të Kosovës ndaj vlerave të Bashkimit Evropian dhe harmonizimit të plotë të Republikës së Kosovës me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së.

Kryenegociatori Zulfaj i falënderoi deputetët gjermanë për mundësinë e takimit dhe për mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë”, thuhet, ndër të tjera, në njoftim.

Rahoveci me qëndrim unik: Aktgjykimi ndaj krerëve të UÇK-së është i padrejtë dhe i papranueshëm



RAHOVEC, 24 SHTATOR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka takuar udhëheqësit e grupeve politike të përfaqësuara në Kuvendin Komunal të Rahovecit, me të cilët janë pajtuar ta mbështesin njëzëri deklaraten kundër aktgjykimit

të shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës ndaj krerëve të UÇK-së, të cilin e kanë konsideruar të padrejtë dhe të papranueshëm. “Me një qëndrim, bashkë me qytetarët e Rahovecit, të bindur plotësisht në pafajësinë e tyre,

vihemi në mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së dhe në rivendosjen e drejtësisë për çlirimtarët. Të bashkuar, për drejtësi, dinjitet dhe në mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së!”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.

TRI VJET NGA RËNIA E AFRIM BUNJAKUT, KËRKOHET DREJTËSI PËR SULMIN NË BANJSKË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ushtruesja e detyrës dhe kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, së bashku me ministrin e Brendshëm, Xhelal Sveçla, drejtorin e policisë, Gazmend Hoxha, ka vizituar në Samadrexhë familjen Bunjaku dhe kanë bërë homazhe te varri i heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku, në trevjetorin e rënies së tij.

Haxhiu ka thënë se tri vjet më parë Afrimi u nis në detyrë dhe nuk u kthye më në shtëpi. “Në Banjskë ai ra duke mbrojtur sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Republikës së Kosovës nga sulmi terrorist i 24 shtatorit. Për Kosovën, Afrim Bunjaku është hero. Për familjen e tij është Afrimi që mungon çdo ditë. Bashkëshorti, babai, vëllai që për 22 vjet kishte veshur uniformën e Policisë së Kosovës dhe i kishte shërbyer vendit të vet. Familjes Bunjaku i shpreha edhe një herë respektin dhe mirënjohjen time të thellë. Afrimi ra në krye të detyrës, por atë mëngjes ai dhe kolegët e tij e mbrojtën Republikën. Për këtë, Kosova do t’i jetë përherë mirënjohëse. Lavdi heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku!”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se në orët e para të mëngjesit të 24 shtatorit 2023, në fshatin Banjskë të Zveçanit ra në krye të detyrës për sundim të ligjit, në mbrojtje të sovranitetit shtetëror dhe tërësisë territoriale të Republikës sonë, rreshteri i policisë, tash hero i Kosovës, Afrim Bunjaku. “Grupi terrorist paraushtarak i organizuar, dirigjuar dhe financuar nga Beogradi, së cilit i printe kryekrimineli Millan Radoiqi, dështoi në sulmin tinëzar që kishte për qëllim konflikt të armatosur e gjakderdhje në manastirin ortodoks të shekullit XIV, mandej aneksimin e veriut të Kosovës, falë vendosmërisë



dhe profesionalizmit të zyrtarëve tanë të rendit e të inteligjencës, politikë e publikë, në mbrojtje të Republikës, të paqes, të drejtave dhe sigurisë për të gjithë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”, duke shkruar se në Banjskë, në vendin e sulmit aty, rruga sot mban emrin e heroit Afrim Bunjaku. “Ndërkaq, tre kriminelë janë vrarë gjatë aksionit atë ditë, tre janë në burg që prej asaj dite, e të gjithë të tjerët do të përgjigjen para drejtësisë në vendin tonë kurdoherë. Shteti ynë asnjëherë nuk do të heqë dorë në kërkim të tyre derisa të gjithë ta kenë marrë gjykimin e drejtësisë dhe dënimin e merituar. Është e vërtetë, ata na kanë bërë dëm e shkaktuar vuajtje, por ne kemi fituar. Shteti ynë i pavarur, Republika e Kosovës, ka ngadhënjyer mbi agresionin dhe krimin, heroit mbi terroristët”, ka thënë Kurti.

Në trevjetorin e rënies heroike, kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka bërë homazhe pranë varrit të Afrim Bunjakut dhe ka vizituar

familjen e tij, për ta përcjellë mirënjohjen dhe respektin e qytetit të Vushtrrisë për sakrificën e tij sublime.

Idrizi ka theksuar se Afrim Bunjaku, hero i Vushtrrisë dhe i Kosovës, do të mbetet përjetësisht shembull i trimërisë dhe përkushtimit ndaj atdheut. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë ka nderuar policin e Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili u vra në krye të detyrës gjatë sulmit të 24 shtatorit 2023 në Banjskë. Në një deklaratë të publikuar, Ambasada Amerikane tha se bashkohet me Kosovën në nderimin e Bunjakut dhe përsëriti thirrjen që autorët e sulmit të mbahen përgjegjës. “Ne i bashkohemi Kosovës në nderimin e policit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili u vra në krye të detyrës gjatë sulmit në Banjskë në shtator të vitit 2023. Ne përsërisim thirrjen tonë që autorët të mbahen përgjegjës”, thuhet në deklaratën e Ambasadës Amerikane. Ambasadori gjerman Rainer

Rudolph ka bërë homazhe pranë varrit të heroit Afrim Bunjaku i cili ka rënë në detyrë në sulmin terrorist të Banjskës tri vjet më parë. Ambasada e Gjermanisë, derisa kujtoi trevjetorin e këtij sulmi, kërkoi që autorët të mbahen

përgjegjës dhe drejtësia të vihet në vend pa vonesa. “Sot shënohen tre vjet nga vrasja e pjesëtarit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku. Udhëheqësi i vetëdeklaruar i sulmit ende nuk është mbajtur përgjegjës. Është e domosdoshme që drejtësia të vihet në vend pa vonesa të mëtejshme”.

Edhe Ambasada e Francës në Kosovë ka përkujtuar policin e vrarë Afrim Bunjaku në trevjetorin e sulmit në Banjskë, duke kërkuar që përgjegjësit për sulmin të përballen me drejtësinë.

Në njoftim bëhet me dije se Marc Ivarra, i ngarkuari me punë i Ambasadës së Francës, vendosi lule në kujtim të tij. “Tre vjet pas sulmit kriminal në Banjskë, i cili i mori jetën rreshterit Afrim Bunjaku, mendimet tona janë me familjen e tij. Franca vazhdon të bëjë thirrje që përgjegjësit për këtë sulm vdekjeprurës të dalin para drejtësisë”, thuhet në njoftimin për media.

Edhe ambasada të tjera në vend kanë kujtuar sot sulmin terrorist të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, duke kërkuar po ashtu që përgjegjësit të sillen para drejtësisë nga autoritetet serbe.

Vendoset gurthemeli i obeliskut për heroin Afrim Bunjaku në Banjskë

Në vendin ku ra heroikisht tre vjet më parë, duke mbrojtur sovranitetin shtetëror dhe tërësinë territoriale të Republikës së Kosovës, në fshatin Banjskë të Zveçanit, është vendosur gurthemeli i obeliskut kushtuar Heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku. Lajmi është bërë me dije nga Qeveria e Kosovës, e cila ka njoftuar për vendosjen e

gurthemelit në vendin ku Afrim Bunjaku humbi jetën gjatë sulmit të armatosur në Banjskë më 24 shtator 2023.

Obelisku do të shërbejë si përkujtim për rënien e heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku, dhe sakrificën e tij në mbrojtje të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës.

KURTI NË NJU-JORK: KOSOVA NUK MUND TË MBETET PENG I SERBISË, BE-ja DUHET T’I JAPË STATUSIN E KANDIDATIT

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në drekën e përfaqësueses së lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe zëvendëspresidentes së Komisionit Evropian, Kaja Kallas, me liderët e Ballkanit Perëndimor në Nju-Jork.

Kurti ka theksuar se statusi i shtetit kandidat për anëtarësim pa vonesa të mëtejme, përveçse i merituar, do të duhej të ishte përgjigjja e Bashkimit Evropian për besnikërinë e Kosovës ndaj vlerave demokratike dhe përcaktimit të qartë strategjik euroatlantik, por edhe veprim

inkurajues për hov të shtuar në përkushtimin tonë për reforma e zhvillim. “Mbajtja në sirtar e aplikimit të dorëzuar në dhjetor të vitit 2022 në Pragë, përderisa jemi tërësisht të linjësuar me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së dhe kemi shënuar përparim të rëndësishëm në pothuaj tërë fushat, përveçse padrejtësi ndaj Republikës së Kosovës do të ishte inkurajim i akterëve destabilizues rajonal dhe më gjerë”, ka shkruar Kurti në rrjetet sociale.

Ai ka thënë se Republika e Kosovës nuk duhet dhe nuk

mund të mbetet peng i fqinjës së saj veriore, shtetit që mbron e shpërblen kriminelët e këtij shekulli dhe glorifikon të tjerët që kryen krime kundër njerëzimit, krime lufte e gjenocid në fund të shekullit të kaluar, në luftërat e ish-Jugosllavisë. “Sikurse, mohon e fshih krimet dhe refuzon të bashkëpunojë në zbardhjen e të vërtetës për të zhdukurit me dhunë, duke pamundësuar drejtësinë. Ndërsa vijon me shkelje të të drejtave dhe spastrim etnik administrativ ndaj shqiptarëve në Luginën e Preshevës”, ka deklaruar Kurti.



Kosova importoi 568 milionë euro mallra më shumë sesa eksportoi në gusht

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Deficiti tregtar i Kosovës arriti në 568 milionë euro në gusht 2026, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Kjo është rritje prej 5,8 % krahasuar me gushtin e vitit të kaluar, kur deficiti ishte 536,8 milionë euro. Kjo i bie që Kosova bleu nga jashtë mallra në vlerë prej 568 milionë eurosh më shumë sesa shiti në tregjet e huaja gjatë po këtij

muaji. Eksportet e mallrave arritën në 100,5 milionë euro, ndërsa importet në 668,5 milionë euro. Krahasuar me gushtin 2025, eksportet u rritën për 31,9 %, kurse importet për 9 %. Me gjithë rritjen më të shpejtë të eksporteve, ato mbuluan vetëm 15 % të importeve. Vendet e CEFTA-s mbetën tregu kryesor për mallrat e



Kosovës. Eksportet drejt tyre arritën në 50,5 milionë euro, ose 50,2 % të totalit. Shqipëria zuri 24,8 % të eksporteve të

përgjithshme të Kosovës, ndërsa Maqedonia e Veriut 13,2 %. Në vendet e Bashkimit Evropian, Kosova eksportoi mallra në vlerë prej 30,3 milionë eurosh. Nga këto vende u importuan mallra në vlerë prej 279 milionë eurosh, ose 41,7 % e importeve të përgjithshme. Importet nga vendet jashtë BE-

së dhe CEFTA-s arritën në 313,3 milionë euro. Në këtë grup, pjesëmarrjen më të lartë në importet e përgjithshme e kishin Kina me 14 % dhe Turqia me 11 %. Sipas ASK-së, metalet bazë dhe artikujt prej tyre përbënin 21,8 % të eksporteve. Në importe, pjesëmarrjen më të madhe e kishin produktet minerale me 19,8 %.

KOMUNAT DHE INSTITUCIONET DISKUTOJNË RRUGËN PËR INVESTIME KOMUNALE NË ENERGJI TË RIPËRTËRISHME

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Asociacioni i Komunave i Kosovës në kuadër të projektit me GIZ-in organizoi takimin me aktorë kryesorë për dialogun ndërinstitucional "Investimet në Burimet e ripërtërishme të energjisë në nivel lokal, për kapacitete të vogla gjeneruese dhe vetëkonsum". Dialogu bashkoi përfaqësues të institucioneve qendrore, operatorëve të sektorit të energjisë dhe komunave, me qëllim të shkëmbimit të informacionit dhe të gjetjes së zgjidhjeve për projektet e BRE-ve në nivel lokal. Përfaqësuesit e Zyrave Komunale për Energji, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përfaqësuesit e KEDS, ZRrE dhe KESCO diskutuan hapat që duhen proceduar për një projekt komunal: kushtet e kycjes në rrjet, statusin e prosumatorit,



marrëdhëniet kontraktuale, matjen dhe faturimin e energjisë. Arsím Osmani nga Asociacioni i Komunave të Kosovës tha se institucionet e nivelit qendror dhe kompanitë operuese në fushën e energjisë duhet të bashkëpunojnë ngushtë me komunat sepse këto nuk janë vetëm çështje teknike. Qartësia e procedurave u mundëson të planifikojnë

investime të realizueshme, të përdorin energjinë e prodhuar për nevojat e tyre dhe t'i menaxhojnë më mirë shpenzimet publike. Kryesuesi i Kolegjiut për Energji të AKK-së, Afrim Prokshi, foli për rëndësinë e trajtimit të nevojave të komunave në procesin e investimeve energjetike. Avni Sfishta, udhëheqës i Projektit

për Energji në GIZ, foli për mbështetjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë fushë. Servet Spahiu, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, trajtoi aspektet e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit që lidhen me zhvillimin e projekteve të energjisë së ripërtërishme. Miftar Nika nga Ministria e Ekonomisë paraqiti zhvillimet dhe masat institucionale për mbështetjen e këtyre projekteve në nivel lokal. Për pjesën e zbatimit, Florian Halimi nga KEDS foli për procedurat e kycjes në rrjet dhe kushtet teknike që duhet të marrin parasysh komunat. Sabri Tërnavë nga KESCO trajtoi marrëdhëniet e furnizimit me prosumatorët, matjen, mekanizmat e faturimit dhe mënyrën e leximit të faturës së energjisë elektrike.

Gani Buqaj nga ZRrE foli për kuadrin rregullativ, statusin e prosumatorit, si dhe të drejtat dhe obligimet që lidhen me investimet komunale. Në diskutimin e hapur përfaqësuesit komunalë paraqitën sfidat dhe nevojat e komunave që hasin gjatë përgatitjes së projekteve për vetëkonsum. Këto projekte kërkojnë më shumë se një vendim për investim: komuna duhet t'i njohë kushtet e kycjes, kërkesat rregullative dhe mënyrën si do të matet e faturohet energjia e prodhuar. Procedurat e qarta dhe komunikimi i rregullt janë të nevojshëm që planet komunale për energji të ripërtërishme të kthehen në investime të zbatueshme. AKK-ja me Kolegjiutin për Energji do të vazhdojnë t'i përcjellin çështjet e ngritura nga komunat dhe ta nxisë bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse.

GUVERNATORI ISMAILI PRITI EKSPERTËT E BANKËS BOTËRORE: QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE, PRIORITET I BQK-së

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me bashkëpunëtorë, zhvilloi takim me ekspertët e lartë të Bankës Botërore, në kuadër të mbështetjes për hartimin e Dokumentit Strategjik të Edukimit Financiar për Qëndrueshmëri Financiare. Kjo nismë zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe Bankës Botërore për përgatitjen e një dokumenti strategjik institucional, i cili synon koordinimin dhe fuqizimin e iniciativave për edukimin financiar dhe shëndetin financiar, në përputhje me

objektivat e Planit Strategjik të BQK-së. Guvernatori Ismaili falënderoi Bankën Botërore për mbështetjen dhe ekspertizën e ofruar, duke theksuar rëndësinë e një strategjie gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe të qëndrueshme, që shkon përtej edukimit financiar tradicional dhe synon t'i fuqizojë përdoruesit e shërbimeve financiare përmes njohurive, praktikave të shëndosha financiare dhe kujdesit ndaj rreziqeve, përfshirë ato kibernetike. Ai nënvizoi rëndësinë e bashkërendimit të kësaj strategjie me atë që pritet të vijojë,



ndërlidhur me infrastrukturën, inovacionin dhe gjithëpërfshirjen financiare si thelbësore për avancimin e qasjes në financa,

fuqizimin e konsumatorëve financiarë dhe zhvillimin e një ekosistemi financiar më gjithëpërfshirës.

Procesi i hartimit të Strategjisë do të zhvillohet nën udhëheqjen e BQK-së, përmes konsultimeve me institucionet publike, sektorin financiar, institucionet akademike, partnerët ndërkombëtarë dhe palët e tjera të interesit. Përmes kësaj Strategjie, BQK-ja synon t'i mbështesë qytetarët, bizneset mikro dhe ato të vogla në vendimmarrje më të informuar financiare, ta forcojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të kontribuojë në një sistem financiar më të qëndrueshëm, transparent, të besueshëm dhe më të qasshëm për të gjithë.

ASK-ja merr pjesë në takimin e Grupit për Politikën dhe Bashkëpunimin Statistikor në Moldavi

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Më 22-24 shtator 2026, në Chişinău të Moldavisë, po zhvillohet Takimi i Grupit për Politikën dhe Bashkëpunimin Statistikor (PGSC), një forum i rëndësishëm për dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet Eurostat-it dhe institucioneve statistikore të vendeve të përfshira në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Në takim po marrin pjesë drejtues të institucioneve


statistikore nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqia, Moldavia dhe Ukraina, si dhe drejtoresha e përgjithshme e Eurostat-it, Mariana Kotzeva. Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) përfaqësohet nga drejtori ekzekutiv, Avni Kastrati, dhe Ibrahim Rustemi nga Drejtoria për Bashkëpunim dhe Koordinim. Gjatë takimit, ASK-ja paraqiti zhvillimet aktuale, prioritetet,

planet dhe projektet madhore për periudhën e ardhshme, me fokus në avancimin e Sistemit Statistikor të Kosovës dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet dhe praktikatat statistikore evropiane. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Eurostat-in dhe institucionet statistikore evropiane mbetet i rëndësishëm për forcimin e cilësisë, harmonizimin dhe modernizimin e statistikave zyrtare në Kosovë.



PATRIOTIZMI I MARK TWAINIT

Për Tom Sojerin dhe sfidën për ta dashur Amerikën.



Nga Ivan KENNEALLY /
The Hedgehog Review

Mark Twaini i përçmonte pa asnjë rezervë festimet e Katër Korrikut, ato kataklizma të zjarra të vetëlartësimit - shpërthimet e fishekzjarrëve të të cilave zënë vendin e “bombave që shpërthejnë në ajër”. Siç e shihnte ai në Lutja e luftës [The War Prayer, 1905], ato ushqejnë prushin gjithmonë të nxehtë të “zjarrit të shenjtë të patriotizmit” dhe nxisin çlirimin e një nacionalizmi të tërbuar. Ai bënte shaka se mijëra njerëz vdesin çdo vit në këto orgji të shovinizmit patriotik - ai vetë kishte humbur dy xhaxhallarë. Ankesa kryesore e Twainit ishte se patriotizmi i lobotomizon ata të cilët e praktikojnë, duke e nënshtruar arsyen me një entuziazëm të pamenduar. Shumica e patriotizmit është “patriotizëm i shumicës”, pohonte ai në Sa i përket patriotizmit [As Regards Patriotism, 1901]: një solidaritet i ngjashëm me atë të tufës, i sajuar me sofizëm prej politikanëve dhe gazetave. Ky nacionalizëm i pamenduar është thjesht një konvencion rutinë i përzier me barat, i ndezur nga një eshkë pasioni dhe mendjelehtësie. Përndryshe, Twaini e përkufizonte patriotizmin e shëndetshëm si patriotizëm “të prodhuar në mjedisin e vetë njeriut ... të arsyetuar në kokën e

vetë njeriut dhe të provuar me zjarr, të testuar dhe të vërtetuar në ndërgjegjen e tij”. Megjithatë, kjo duket kërkesë e madhe për atë që ai, te Jeta në Misisipi [Life on the Mississippi], e quante “komb qyqarësh morale”, qytetarët e të cilit shfaqin një “ndjeshmëri të skajshme” ndaj kritikës dhe një terror nga sfidimi i ndjenjës së konsensusit, me çdo hap të vogël jashtë qarkut të rehatshëm të konsensusit publik të shpallur si apostazi. E gjithë kjo ngre - dhe synonte të ngrinte - pyetjen se çfarë përbën patriotizëm të duhur, një dashuri vërtet racionale për vendin e dikujt. Një dashuri e tillë, së paku, do t'i ofrohej njeriut të dashur që ia kthen dashurinë dhe që e meriton adhurimin. Por, a mund të jetë ndonjë dashuri e vërtetë e vullnetshme në mënyrë kaq të përllogaritur, siç duket se nënkuptojnë nocionet tona të pranuar për një kontratë shoqërore? Edhe partnerët në një martesë të rregulluar nga prindërit e tyre synojnë një bashkim më romantik se ky, një bashkim që nuk mund të reduktohet në një përllogaritje kaq të pandjeshme. Dhe, kontrata shoqërore, si çdo kontratë, nënkupton mosbesim të ndërsjellë, një garanci të interesave vetjake dhe jo zotim të përzemërt besnikërie. Ndoshta model më i përshtatshëm për patriotizmin është dashuria që njeriu ka për

prindin, jo ajo e fëmijës së vogël, por e njeriut të moshës së mesme që dashuron me sy hapur, tejet i ndjeshëm ndaj dobësive dhe neglizhencave të prindit, madje edhe ndaj tradhtive. Kështu i donte Twaini prindërit e vet, pavarësisht dështimeve të njëpasnjëshme të babait të tij si sipërmarrës - të cilat e mbanin familjen të zhytur në vështirësi financiare - dhe mbështetjes së papenduar të së ëmës për skllavërinë. I duam prindërit tanë sepse janë tanët, lidhje kjo që sfidon çdo shpjegim krejtësisht racional. Nga fati na jepen prindërit, ashtu siç fati na lë trashëgim prejardhjen tonë kombëtare - gjendje po aq e patjetërsueshme sa të drejtat tona. Hakëllberi Fini e shpreh këtë nderim me himnin e tij të famshëm e të bukur për lumin Misisipi, duke mbajtur një monolog për kombinimin e dashurisë dhe frikës së tij ndaj një pothuajse-perëndie që është po aq i njohur sa është i largët. Megjithatë, është Tom Sojeri ai që i afrohet më shumë kapjes së asaj që shumica e njerëzve nënkuptojnë me patriotizëm, kur ai i shpjegon Hakut ritet e inicimit të bandës së tij: “Është të betoheni se do t'i qëndroni pranë njëri-tjetrit dhe kurrë të mos i tregoni sekretet e bandës, edhe nëse ju bëjnë copë e grimë, dhe të vrisni këdo që lëndon njërin nga banda, bashkë me gjithë familjen e tij”. Rrëfimi i tij të kujton përkufizimin e

drejtësisë që Polemarku jep te Republika e Platonit: t'u bësh mirë miqve dhe t'u bësh keq armiqve. Nuk është e lehtë të formulosh një përkufizim të patriotizmit pa iu drejtuar gjuhës luftarake, dhe pikërisht për këtë Twaini e ekzagjeron qëllimisht përbërësin racional të patriotizmit në kurriz të elementit të tij fisnor. Aventurat e Tom Sojerit [The Adventures of Tom Sawyer] e Twainit - që tani po shënon 150-vjetorin e botimit të tij - është paraqitja në formë romani e edukimit të një djali të ri në qytetari të përgjegjshme, në patriotizëm të shëndoshë dhe të matur. Si e tillë, është ripunim amerikan i Emilin [Émile] të Rousseaus, ku kotësia pa fund e Tomit, dëshira e tij për nder e shkëputur në mënyrë fëmijërore nga çdo meritë morale, duhet të shndërrohet në fisnikëri të vërtetë, por që ende është në përputhje me një shoqëri tërësisht egalitare. Në fillim të librit, ai do fitim pa punë, dashuri pa besnikëri dhe veçim shpirtëror pa devotshmëri. Ai madje ëndërron një vdekje “të përkohshme”, pa dhimbje dhe parehati, që do t'i lejojë ta shohë qytetin duke vajtuar vdekjen e tij. Në vend të fisnikërisë, ai mjaftohet me një famë të rreme, një narcizëm të papjekur. Për më tepër, Tomi është gjithçka tjetër përveçse i vetëmjaftueshëm nga ana racionale: ai u bindet me përpikëri rregullave - zakonisht

vetëm gjysmë të kuptuara - nga romanet të cilëve u është përkushtuar me po aq zell sa një rabin Talmudit. Me gjithë prapësitë e tij të shfrenuara, Tomi digjet nga dëshira për t'u lavdëruar pikërisht nga institucionet që sfidon, ndërsa antinomizmi i tij i rremë nuk është veçse një rrugë e shkurtër drejt suksesit konvencional. Dhe, megjithëse kënaqet në shoqërinë e “të përjashtuarit të ri të fshatit”, ai “nuk donte ta kishte shoqërinë e Hakut në vende publike”. Kur Haku kundërshton të heqë dorë nga ekzistenca e tij “pa ligj”, nga mungesat e tij të përhershme nga shkolla, Tomi kërcënon ta përjashtojë nga banda e tij e piratëve, loja e të cilëve me të qenët jashtë ligjit është krejtësisht e respektueshme. Tomi e sheh pasurinë vetëm si mënyrë për të siguruar vendin e tij në shoqërinë e respektueshme, jo si mjet për të blerë lirinë e tij prej saj. Ai rrëfen se, nëse e gjen ndonjëherë plaçkën, do të blejë një kravatë të kuqe dhe do të martohet. Një pjesë e tërheqjes së tij ndaj Bekit, nuk mund të mos mendojmë këtë, i detyrohet faktit se ai “e adhuron” babanë e saj, gjyqtarin Theçer, një shtyllë e nderuar e komunitetit. Megjithatë, vetëm nën ndikimin e Bekit Tomi vepron ndonjëherë me nder pa u shqetësuar për njohjen publike, duke marrë rrahje për të në shkollë pasi rrëfen se kishte kryer një shkelje të cilën e kishte

bërë ajo. Për më tepër, ndërsa janë të humbur në një shpellë, ai ia jep asaj pjesën e tij nga ushqimi i tyre që po pakësohej, një akt sakrifice i kryer krejt fjalë për fjalë në errësirë, përtej vëmendjes së admiruesve të mundshëm. Tërheqja e një vajze të respektueshme ka fuqi të jashtëzakonshme për ta përmbajtur ambicien e një djali të ri. Kjo është arsyeja pse, sipas rrëfimitarit të tregimit, martesë është përfundimi i natyrshëm për çdo roman me protagonistë të rritur, sepse bashkon erosit përvëlues me respektueshmërinë morale. Megjithatë, Tomi është ende veçse djalë - jo më shumë se trembëdhjetë vjeç - dhe vetëm në një fazë embrionale të formimit moral. Me gjithë krekosjen e tij ekzibicioniste, ai pengohet nga një “frikë e tmerrshme nga skena” kur i jepet mundësia të recitojë një fjalim të famshëm të Patrick Henryt para një audience të detyruar ta dëgjojë. Ashtu siç Tomi nuk arrin t'i deshifrojë plotësisht librat që lexon, ai e ka të vështirë t'i deshifrojë rolet dhe ndalimet e shtresëzuara në mënyrë rigjide të shoqërisë së vet, gjë që shpjegon pse parapëlqen të sjellë ujë - punë kjo e një skllavi si Xhimi - sesa punën shtëpiake të lyerjes së gardhit me gëlqere. Shenja më e qartë se Tomi po fillon ta zbusë nevojën e tij për renome është kur, dy herë, ridrejton një pjesë të vëmendjes që tërheq te Haku. Teksa parakalon me hap të shkujdesur drejt funeralit të vet, Tomi e nxit bashkësinë e ngazëllyer ta mirëpresë edhe Hakun. Përveç kësaj, pasi e veja ofrohet ta marrë Hakun në shtëpi dhe t'i mësojë si ta fitojë jetesën, Tomi feston pavarësinë financiare të sapofituar të Hakut, rezultat i gjetjes së plaçkës së gangsterëve. “Hakut nuk i duhet. Haku është i pasur!” Tomi provon pak se si është ta ndajë qendrën e vëmendjes që zakonisht e mban me lakmi për vete.

Siç vëren gjyqtari Theçër, Tomi e ka potencialin të bëhet avokat ose oficer ushtarak, qytetar produktiv që meriton vlerësimin e fqinjëve të vet. Rreziku i prirjeve çapkëne të Tomit dhe i nënshtrimit të tij ndaj konvencionit është se ai mund të bëhet imperialist krekosës si Theodore Roosevelt. Siç e shprehu Twain te Autobiografia [Autobiography, 1907]: “Z. Roosevelt është Tom Sojeri i shekullit të njëzetë, gjithmonë duke u krekosur; gjithmonë duke kërkuar një mundësi për t'u krekosur; në imagjinatën e tij të tërbuar, Republika e Madhe është një cirk i stërmadh Barnumi, me të si palaço dhe gjithë botën si audiencë; ai do të shkonte në Halifaks për gjysmën e një mundësie që të krekosej dhe do të shkonte në ferr për një mundësi të plotë”. Kërkimi i kotë i Tomit për nder dhe njohje bie në sy edhe më fort përballë egalitarizmit të plotë të shoqërisë amerikane. Në mungesë të çfarëdo hierarkie të vendosur, njeriu duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të fituar shquarjen. Por, personi që kërkon dëshpërimisht të shquhet mund të arrijë t'i përçmojë njerëzit ose institucionet që ia japin atë. Shkolla e së dielës është “një vend të cilin Tomi e urrente me gjithë zemër”, por megjithatë ai “digjej për një nga ato çmime” për dije biblike dhe “pa dyshim, e gjithë qenia e tij kishte dëshiruar prej shumë ditësh lavdinë dhe shkëlqimin që vinin bashkë me të”. Prirjet konvencionale të Tomit nuk janë askund më të dukshme sesa në përkushtimin e tij ndaj letërsisë romantike sentimentale. Ai dëshiron me zjarr të jetë revolucionar si Robin Hudi, për të cilin deklaroi se jo vetëm është “njeriu më i madh që ka jetuar ndonjëherë në Angli”, por thjesht “njeriu më fisnik që ka jetuar ndonjëherë”. Robin Hudi vjedh nga të pasurit për t'i ndihmuar të varfrit, një kryengritje filantropike kundër

feudalizmit sundues, e bërë edhe më radikale nga statusi i tij si kont - të paktën në portretizimet që nga fundi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Megjithatë, Tomi jeton në një botë pa hierarki rangjesh. Në fjalimin e tij të Katër Korrikut, të mbajtur në Londër (1873), Twaini e kremtoi dëbimin e fisnikërisë si pikë të mirëfillte krenarie për Amerikën. “Ne kemi një formë qeverisjeje që i jep secilit njeri mundësi të drejtë dhe asnjë favor. Te ne, asnjë individ nuk lind me të drejtën ta shohë nga lart fqinjin e vet dhe ta përçmojë”. Megjithatë, riluajtja e melodramës së aventurave të Robin Hudit i lejon Tomit të luajë me radikalizmin politik, ndërsa rebelimi i kusarit të famshëm tashmë është përfshirë në mënyrë të sigurt në ideologjinë zyrtare të kohës. Tomi përfytyron se fiton famë duke u rebeluar kundër një tiranie që nuk ekziston më, duke përjetuar dramën e rebelimit pa tradhtuar besnikërinë e tij të palëkundur ndaj ligjit. Një problem i dukshëm me besnikërinë e Tomit ndaj konvencionit është se konvencioni dominohet nga ajo që Twain diku tjetër e quajti një “qull të moraleve të sakatuara”. Amour propre e Tomit është pasqyrim i dekadencës morale të kohës dhe zmadhohet nga fakti se ai nuk përjeton aspak përjashtimin shoqëror me të cilin përballlet Haku. Megjithatë, letërsia i ofron Tomit mundësinë të përvetësojë normat morale të një kohe më pak të korruptuar, duke imituar në njëfarë mënyre tjetërsimin që Haku përjeton në jetën reale, për aq sa ajo ngre një pengesë mes tij dhe konvencioneve të kohës. Me gjithë ankesat e Twainit për nevojën e një patriotizmi më racional, Aventurat e Tom Sojerit rekomandon një strategji më poetike për edukimin në liri të rinisë më premtuese të kombit. Tomi duhet edhe të ngrihet moralisht, edhe të frymëzohet,

dhe edukimi i flashkët të cilit i nënshtrohet, në klasë dhe në kishë, është thellësisht i papërshtatshëm për të dyja këto detyra. Twaini e refuzon veprën si të Fenimore Cooperit ashtu edhe të Ben Franklinit pikërisht për këtë arsye - predikimi i tyre homiletik i ndrydh energjitë rinore në vend që t'i sublimojë ato përmes sfidave që nxisin pavarësinë dhe mbështetjen te vetja. Te Sa i përket patriotizmit, Twaini pohon se ndrojtja jonë e natyrshme mund të kapërcehet përmes një lloj “stërvitjeje”. “Atëherë njerëzit mund të stërviten për ta prodhuar vetë patriotizmin e tyre. Mund të stërviten që ta përpunojnë atë në kokat dhe në zemrat e tyre, dhe në privatësinë dhe pavarësinë e mjedisit të tyre”. Megjithatë, kjo stërvitje ofrohet shumë më efektshëm nga lloji i duhur i letërsisë dhe lloji i duhur i lojës sesa nga çfarëdo kurrikule arsimore programatike. Në vitin 1887, Twaini e quajti Aventurat e Tom Sojerit një “himn”, me sa duket për të sugjeruar se ishte një romantizim nostalgjik jo vetëm i pafajësisë rinore, por edhe i kohës dhe vendit brenda të cilëve zhvillohet tregimi. Misuri para Luftës Civile paraqitet si mjedisi ideal për vitet e hershme të një djali, një mjedis që duket homogjen në aspektin fetar dhe kulturor, kryesisht i paprekur nga konflikti klasor dhe përmbysjet shoqërore të kohës. Nuk ka asnjë shenjë të “asaj tronditjeje të madhe”, siç e quante Henry James Luftën Civile, që po afrohet me shpejtësi dhe në mënyrë të pashmangshme. Për sklavërinë pothuajse nuk diskutohet fare. Megjithatë, edhe lexuesi më i pavëmendshëm mund të shohë shenja paralajmëruese të kalbëzimit moral, sado që këto shenja të jenë errësuar nga përqendrimi te aventurat çapkëne të Tomit. Të duash vendin do të thotë, ndoshta, ta idealizosh duke i zmadhuar virtytet dhe duke i shpërfillur veset. Miti themelues

i vendit tonë mund të përdoret për këtë qëllim. Por, censurimi sentimental duhet të baraspeshohet me kritikë të kthjellët, dhe kjo mund të bëhet duke bërë dallimin mes shpirtit të qëndrueshëm të një kombi dhe cilësdo qeverie që përkohësisht e drejton atë. Henk Morgani, protagonist i Një Jenki i Konektikatit në oborrin e mbretit Artur [A Connecticut Yankee in King Arthur's Court] të Twainit, e shpreh mirë këtë dualizëm: “E shihni, lloji im i besnikërisë ishte besnikëri ndaj vendit, jo ndaj institucioneve ose mbajtësve të posteve të tij. Vendi është gjëja e vërtetë, gjëja thelbësore, gjëja e përjetshme; ai është ajo për të cilën duhet kujdesur e vigjiluar, dhe ndaj së cilës duhet qenë besnik; institucionet janë të jashtme, ato janë vetëm veshja e tij, dhe veshja mund të konsumohet, të bëhet e leckosur, të pushojë së qeni e rehatshme, të pushojë së mbrojturi trupin nga dimri, sëmundja dhe vdekja”. Aventurat e Tom Sojerit është reflektim mbi mënyrën se si duhen rritur djemtë e rinj që të bëhen burra siç duhet, patriotë, ta duan vendin e tyre me gjithë të metat e tij dhe të kërkojnë nder pa i përçmuar ata që ua japin atë. Twaini përfundimisht u pajtua me mikun e tij William Dean Howells, që ta tregtonte si “libër për djem”, por kurrë nuk synoi që të ishte i tillë: parathënia u drejtohet të rriturve, të cilët ftohen të kujtojnë fëmijërinë e tyre tani që u është besuar detyra e rritjes së fëmijëve të tyre. Me vend, Twaini ia kushton librin jo fëmijëve të tij, por Livyt, nënës së tyre dhe gruas së tij. Nuk mund të mos e duam vendin tonë, sepse, duke ia mohuar dashurinë, duke e urreyer, nuk mund të mos e urrejmë veten. Twaini këshillon që ta duam vendin tonë ashtu siç i duam prindërit: me besnikëri, duke falur, dhe me aq kthjelltësi kritike sa lejon natyra e dashurisë. /Telegrafi/



eg

EURO
GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë

Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336

E-mail: euro.glass@live.com

Montim

Servisim

Perdorim

QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

DONJETA SADIKU HUMB NË GJYSMËFINALE, MBETET ME MEDALJE TË BRONZTË EVROPIANE

SOFJE, 24 SHTATOR - Donjeta Sadiku është ndalur në gjysmëfinale të Evropianit të boksit amator që po mbahet në Sofje të Bullgarisë. Sadiku, në kategorinë deri në 60 kilogramë, ka humbur me rezultat 4:1 nga boksierja e Serbisë, rusja Kristina Kuluhova. Garuesen e Serbisë e kishte mposhtur në finalen e Lojërave Mesdhetare “Taranto 2026”, por jo edhe të enjten. Megjithatë, Donjeta ka siguruar vend në podium. Boksierja 27-vjeçare e ka siguruar të mërkurën medaljen e bronzte pas fitores në çerekfinale kundër boksieres nga Holanda, Maud van der Toorn.

BURNLEY NXJERR NË SHITJE BROJËN

LANCASHIRE, 24 SHTATOR - Armando Broja pritet të largohet nga skuadra e Burnleyt në afatin kalimtar të janarit, kanë raportuar të mërkurën medimet britanike. Është bërë me dije se drejtuesit e Burnleyt kanë vendosur ta nxjerrin Brojën në shitje dhe po presin ofertën e duhur për lirim e tij. Sulmuesi i Shqipërisë nuk bën pjesë në planet e Burnleyt dhe, për këtë arsye, pritet të largohet nga klubi, me të cilin ka kontratë deri në vitin 2030. Për kartonin e tij, ekipi që garon në Championship po kërkon të paktën 10 milionë euro dhe shpreson të ketë skuadra të interesuara për shërbimet e Brojës. Në sezonin aktual, Broja ka bërë vetëm gjashtë paraqitje për Burnleyn në të gjitha garat, duke regjistruar gjithsej 216 minuta lojë. Ai është transferuar te Burnley në verën e vitit të kaluar, ndërsa ekipi anglez i ka paguar Chelseat 23 milionë euro për kartonin e 25-vjeçarit.

MANCHESTER UNITEDI SIGURON TOKËN PËR STADIUMIN E RI ME 100 MIJË VENDE


MANCHESTER, 24 SHTATOR - Manchester United ka bërë një hap të madh drejt ndërtimit të stadiumit të ri, me kapacitet prej 100 mijë tifozësh. Klubi ka konfirmuar se ka siguruar tokën ku parashihet të ndërtohet arena e re, duke e cilësuar këtë si një çast të rëndësishëm në kuadër të projektit. CEO i Manchester Unitedit, Omar Berrada, ka deklaruar se klubi po punon dhe është i fokusuar në planet për zhvillimin e stadiumit të ri. Stadiumi i ri pritet të jetë një nga projektet më ambicioze në historinë e klubit, ndërsa puna për fazat e ardhshme tashmë ka nisur.

ALABA I BASHKOHET UDINESES

UDINE, 24 SHTATOR - Skuadra e Serisë A të Italisë, Udinese, ka bërë një lëvizje të papritur duke u përforcuar me futbollistin David Alaba. Alaba të enjten ka kaluar me sukses testet mjekësore dhe me Udinesen ka firmosur kontratë deri në fund të këtij sezoni, me opsionin e vazhdimet edhe për një vit tjetër. Ai te skuadra italiane është transferuar si futbollist i lirë, pasi në fund të muajit qershor i ka skaduar kontrata me Real Madridin, ekip për të cilin ka luajtur për pesë sezone. Në prezantimin e 34-vjeçarit, Udinese ka bërë me dije se ekipit i është bashkuar një kampion i vërtetë si Alaba, i cili do të shtojë përvojë dhe lidërsip. Për Alaban, zhvendosja në Serinë A të Italisë do të jetë një aventurë e re në karrierën e tij të pasur dhe të suksesshme. Krahas Real Madridit, Alaba ka luajtur edhe në Bundesligën e Gjermanisë, ku ka bartur fanellën e Bayern Munichut dhe Hoffenheimit.

10 top-futbollistët që mund të transferohen falas

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Edhe pse afati kalimtar veror ka përfunduar, klubet mund të transferojnë lojtarë që janë pa kontratë. Në tregun e lirë ndodhen disa emra të njohur, mes tyre Karim Benzema, Jadon Sancho, Paul Pogba dhe Dani Carvajal. Lista përfshin gjithashtu Riyad Mahrez, Mauro Icardi, Oleksandr Zinchenko, Wilfried Zaha, Raheem Sterling, Anthony Martial dhe Raphaël Guerreiro. Këta futbollistë mund të negociojnë me klubet edhe jashtë afatit të zakonshëm, ndërsa regjistrimi i tyre varet nga rregullat e secilit kampionat.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lisi Group” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810845167 bënë ulje të kapitalit nga 140,000.00 në 1000.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Vjosa (Jusuf) Gradinaj, shpall të pavlefshme certifikatën e dhënies së Provimit të Jurisprudencës, me nr. 91/2017, të lëshuar në Prishtinë më 13.03.2017, për provimin e jurispru-dencës të dhënë më 31.01.2017, nga Ministria e Drejtësisë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Vjosa Jusuf Gradinaj shpall të pavlefshme diplomën LL.M. (Master) në Kontrata dhe të Drejtën Komerciale, në emër të, nr. 1689, të lëshuar më 27.02.2018, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biz-nesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biz-nesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.
- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
